

## EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

### KOMPONENTI 4 – TË DREJTAT E NJERIUT DHE SANKSIONET ALTERNATIVE

#### Konkurs

#### Pozitë afatmesme kombëtare: Ekspert afatmesëm kombëtar në fushën e të drejtave të fëmijëve

Punëdhënësi:	Instituti Ludwig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut
Lokacioni:	Shkup, Maqedonia e Veriut
Lloji:	Angazhim afatmesëm
Fillimi i pritshëm:	Dhjetor 2021
Kohëzgjatja e pritshme:	njëzet e dy muaj, Dhjetor 2021-Tetor 2023

#### HISTORIA

Eksperti kombëtar afatmesëm në fushën e të drejtave të fëmijëve do të punojë si pjesë e ekipit zbatues për projektin e financuar nga granti i Bashkimit Evropian “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” në Maqedoninë e Veriut. Projekti zbatohet nga një partneritet ndërkombëtar me përvojë i udhëhequr nga Agjencia për Integrim Evropian dhe Zhvillim Ekonomik GmbH dhe tre bashkë-aplikantë – Ministria e Drejtësisë dhe Administratës e Republikës së Kroacisë, Ministria e Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Instituti Ludwig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të forcojë sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut. Komponenti 4 e zbaton objektivin e mëposhtëm specifik: Të rrisë mbrojtjen e të drejtave themelore dhe përdorimin e mjeteve alternative të paraburgumit. Për ta arritur këtë, Komponenti synon të prodhojë 8 rezultate. Midis tyre, eksperti do të punojë veçanërisht në:

- **Forcimin e politikave për të drejtat e fëmijëve dhe sistemin për mbrojtjen e fëmijëve**

Eksperti kombëtar afatmesëm në fushën e të drejtave të fëmijëve do t'i bashkohet ekipit të projektit në përmbushjen e një sërë detyrash dhe do të kontribuojë ndjeshëm në rezultatet dhe aktivitetet e përshkruara hollësisht më poshtë.

#### ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E EKSPERTIT

Ai anëtar i ekipit të projektit:

- Të komunikojë dhe të ndërlihet me palët përkatëse të interesit për të drejtat e fëmijëve për të forcuar politikën për të drejtat e fëmijëve dhe sistemin e mbrojtjes së fëmijëve

## EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

- Përgatitja e analizave, identifikimi i mangësive dhe nevojave për çështje specifike dhe ofrimi i rekomandimeve në lidhje me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve
- Hartimi i rekomandimeve praktike dhe kornizës legjislative (udhëzime, akte nënligjore,...) për përmirësimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të fëmijëve
- Mbështetja dhe udhëzimi i krijimit të një instrumenti të përshtatur për monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave duke lehtësuar panelet për të drejtat e fëmijëve për të konceptuar një kornizë të monitorimit të të drejtave të fëmijëve
- Të formulojë aktivitete të orientuara drejt veprimit dhe të zhvillojë tregues të të drejtave të fëmijëve bazuar në standardet ndërkombëtare
- Sigurimi i përfshirjes së drejtpërdrejtë të fëmijëve në aktivitetet e projektit për të drejtat e fëmijëve
- T'i mbështesë aktivisht aktorët kombëtarë në hartimin e një Plani kombëtar të veprimit për të drejtat e fëmijëve
- Të bashkëpunojë me ekipin e projektit dhe palët përkatëse të interesit për përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese për të drejtat e fëmijëve

### KËRKESAT

- Arsimit relevant universitar (e pëlqyeshme juridik)
- Rrjedhshmëri në gjuhën angleze dhe maqedonase, në të shkruar dhe të folur
- Përvojë e dëshmuar në punë lidhur me të drejtat e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriu (minimumi 5 vjet)
- Përvojë dhe shkathtësi në hulumtime, analiza dhe raportim
- Njohuri mbi monitorimin e të drejtave të njeriut
- Përvojë në hartimin e dokumenteve strategjike në fushën e të drejtave të njeriut
- Aftësi për të bashkëpunuar me partnerët e projektit në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe për të komunikuar me ta në mënyrë efektive
- Aftësi të forta rrjetëzimi
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi me gojë dhe me shkrim
- I ndjeshëm ndaj mjedisit politik, aftësi të shkëlqyera analitike, qasje pragmatike, i fuqishëm në të menduarit strategjik dhe planifikim operacional
- Fleksibilitet, aftësi të fuqishme përshtatjeje dhe aftësi për punë ekipore në një mjedis potencialisht stresues nën afate të ngushta

### PËRPARËSITË:

- Përvojë e përfshirjes së fëmijëve në zhvillimin e politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve

### DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Aplikacionet duhet të dërgohen në [dieter.schindlauer@rol.mk](mailto:dieter.schindlauer@rol.mk) deri më 17.12.2021, duke shënuar "National Mid-Term Expert Children's Rights" në titullin e e-mail-it (subject) dhe duke

## EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

përfshirë një CV të formatit Europass në gjuhën angleze dhe një letër motivuese. Aplikacionet e dërguara pas përfundimit të afatit ose aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në një listë më të ngushtë do të ftohen për një intervistë personale.

Eksperti i përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë me Institutin Ludwig Boltzmann për të Drejtat Themelore dhe të Njeriut dhe do të ketë statusin e të vetë punësuarit. Do të jetë përgjegjësia e tij/saj e vetme që të respektojë të gjitha kërkesat ligjore për vetëpunësim si dhe të mbulojë të gjitha taksat dhe tarifat e parashikuara.

“Eksperti nuk duhet të ketë pasur kontratë pune me administratën publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut së paku 6 muaj para punësimit”.